Faza e kamerale përfshin formimin e një raporti teknik (përfundimtar). Inxhinieret vlerësojnë të dhënat fillestare (të mëparshme) dhe të marra, përshkruajnë tiparet e sondazheve inxhinierike dhe gjeologjike, llojet e tokës, parametrat e vendndodhjes dhe i japin objektit një karakteristikë. Më pas analizohen të dhënat e marra nga laboratorit. Në bazë të rezultateve të hulumtimit përpilohet një raport përfundimtar dhe nxirren përfundime të përgjithshme. Në përfundim, specialistët e kompanisë “Zenit &co” japin rekomandime, duke pasur parasysh detyrat që vetë klienti ka vendosur për inxhinierët e kompanisë sonë. Nëse vlerësojmë kostot e kohës, atëherë pjesa më e madhe e kohës kërkohet pikërisht në fazën e kamerale.

### **3. NDERTIMI GJEOLGJIK DHE HIDROGJEOLGJIK**

Ne kete kapitull do te trajtojme perberjen gjeologjike te zones duke shfrytezuar punimet ekzistuese dhe punimet e kryera ne terren nga “ZENIT &CO” shpk. Bazuar ne materialin e grumbulluar po shtjellojme kushtet gjeologjike te ndara ne studimet ekzistuese dhe ne studimet e reja te kryera nga grupi i studimit.

#### **3.1 Studimet Ekzistuese**


Ne zonen e brigjeve te lumit te “Tiranes”, lumit te “Lanes”, “Kodres se Priftit” dhe “Paskuqanit” “Freskut”, jane kryer shume studime rajonale dhe lokale. Keto studime jane kryer per objektet e ndryshme qe kane te bejne me qendrueshmerine e shpateve te kesaj zone si dhe per projektimin e themeleve te godinave te reja shumekateshe qe jane ndertuar ne kete zone. Tirana ben pjese ne zonen e Ultesires Perendimore te Shqiperise. Ne kete zone jane prezente depozitimet Neogjenike dhe depozitimet e Kuaternarit, por ne zonen ku do te ndertohet objekti jane prezente depozitimet e meposhtme:

#### **3.2 Depozitimet Neogjenike (N<sub>1</sub><sup>2t</sup>)**

Keto depozitime perfaqesohen nga argjilite, ranore. Jane me çimentim te dobet argjilor dhe me çarje. Keta shkembinj perajrohen lehte nga agjentet atmosferike dhe lageshtia duke krijuar nje cipe te trashe te mbuleses deluvialo-aluviale. Takohen nen depozitimet e Kuaternarit ne thellesite 5.80–8.3m. Ne shpatet e kodrave mbulesa deluvialo-eluviale rreshqet ne drejtim te renies se relievit, por ne rastin tone sheshi i studiuar eshte ne terren te Pjerret , prandaj eshte i kercenuar nga ndonje rreshqitje e mundshme.

#### **3.3 Depozitimet deluvialo-aluviale**

Keto depozitime perfaqesohen nga suargjila, surera, rera dhe me rralle takohen shtresa zhavorore. Jane pak deri mesatarisht te ngjeshura. Takohen ne pjesen e siperme te prerjes dhe kane trashesi 5.8 –8.3m.por vende vende dalin dhe rrenjesore te perfaqsuar nga ranoret e tortonianit Jane depozitime te drluvioneve dhe proluvioneve , te cilat nderthuren nedepozitimet deluviale. Mbi keto depozitime mundet te mbeshteten themelet e rrugeve dhe te veprave te vogla, por per themelet e urave qe nderpresin lumin rekomandojme qe te mbeshteten ne formacionet rrenjesore .




Feagment nga harta gjeologjike dkematike

### 3.4 Kushtet Hidrogjeologjike

Nga studimet e kryera ne brigjet e lumit te “Tiranes”, lumit te “Lanes”, ne “Kodrat ePaskuqanit” “Kodres se Priftit” dhe Freskut (nga matjet e kryera ne shpimet per disa vite ne punimete ndryshme qe autoret kane kryer per kete zone), rezulton se niveli i ujit nentokesor ne dimedhe ne vere eshte i ndryshem. Ne dimer ai eshte shume afer siperfaqes ndersa ne vere dhe nevjeshite ai takohet ne thellesi te madhe. Autoret e ketij studimi kane shfrytezuar te gjithapunimet ekzistuese dhe punimet e reja. Ne to jane kryer matje ne disa kohe gjate gjithheperiudhes se studimit dhe rezulton se ne pjesen me te madhe te zones niveli i ujit nentokesor eshte shume afer siperfaqes se tokes ( -1.20m -5.30m), por duhet te theksojme se niveli i ujit nentokesor varet shume dhe nga niveli i ujit ne lumin e Tiranes. Nga analizat e kryera rezulton se jane ujra neutrale, ato nuk jane agresive ndaj hekurit dhe betonit.

Projekti yne ne zonen e Freskut perfaqsohet :



Fragmente nga harta skematike hidrogeojekt

## 2.Shkembinj kompakt me ujembajtite mesatare:-

Ne kete kompleks kemi klasifikuar formacionet gjeologjike:

- depozitime te Tortonianit-  $N_1^3t(a)$ -molasa gelqerore litotamnike, ranore konglomerate, ranore,
- depozitime te Tortonianit-  $N_1^3t(c)$  , konglomerate, ranore, alevrolite,
- depozitime te Mesinianit-  $N_1^3m(a+b)$ - , konglomerate, ranore, alevrolite
- ,depozitime te Pliocenit-  $N_2^1h (b+c)$ - argjila, ranore, konglomerate, alevrolite
- depozitime te Burdigalianit-  $N_1^1b (b)$ - argjila, ranore, alevrolite konglomerate

Akuiferi i ranoreve Tortonianit, Mesinianit, burdigalianit me perberje litologjike argjila, alevrolite, ranor, molasa, gelqerore litotamnike kane perhapje relativisht te madhe ne basen. Dalin ne siperfaqe ne forme brezash me shtrirje JL-VP ne verilindje e veriperendim te Tiranes nga F.Kruja (Laci), Borizana, Radheshi, Qinami, ZallHerri, Priska, Berzhite, Ibe, Lalzi(QafaGurit), Kuratni, Gerdeci, Marqineti, Marikaj, Saue ti, Pinet, Gerblleshi, Zbarqja, Gropaj, Mezezi, Bozanxha, Romanat, Zhurja, Ndroq, etj. Ai nderton dhe rrethon zonen kodrinore te Q.Tiranes dhe perfaqesohet nga nderthurje te ranoreve shtrese

trashe me çimentim mesatar, argjilave e alevroliteve, me ndershtresa te rralla gelqeroresh litotamnike te Tortonianit. Thellesia e tyre nen depozitimet kuaternare rritet drejt detit Adriatik. Prurja specifike luhetet  $q=0.0017-0.02-0.05$  l/sek/m. Shpimet japin prurje  $Q=0.5-2-5$  l/sek. Vlen të permendim se dhe në kete kompleks ujëmbajtës janë vënë në shfrytëzim një numër i madh shpimesh. Ujerat nentokesore te ketij grupi kane perhapje te madhe ne njesine kodrinore. Ato formojne shtresa ujembajtese me çarje dhe poro-çarje me resurse te ndryshueshme ujerash nentokesore. Shtresat ujembajtese jane me presion dhe ne siperfaqe te gjera shpimet japin uje me vetederdhje me prurje nga 0.1 deri 1-2 l/sek. Ujerat e ketij kompleksi jane studjuar me nje numer pusesh fshati, burime me prurje te vogel dhe shpime, ku jane kryer matje niveli, prurje dhe analiza te kimizmit te tyre. Ne kete zone formacioni ujembajtes perfaqesohet nga ranore shtrese trashe me çimentim mesatar, me ndershtresa te rralla gelqeroresh litotamnike te Tortonianit. Ato kane renie perendimore dhe perbejne bazamentin e pellgut ujembajtes te zhavorreve aluviale. Uji i ketij kompleksi eshte i nje cilesie te mire dhe perdoret per furnizimin me uje nga familje. Ai ka nje mineralizim 371.64-561.9mg/l,  $Fp=10.64$  grade gjermane, temperature 14-17°C dhe prurje specifike te ulta. Burimet ne rajonin e permendur jane te rralle, me prurje mesatarisht 0.1 l/sek, pa ndonje rendesi praktike per furnizimin me uje te pijshem. Formacionet e tortoniani jane kapur me shpime ne Bilaj, shpimi nr.75 Bilaj. Uji ka  $Fp=30.8$  grade gjermane, ndersa mineralizimi i pergjithshem eshte  $Mp=1020.67$  mg/l. Uji eshte i tipit  $HCO_3-Mg-Ca$ . Ne Borizan shpimi Nr.35, uji ka  $Fp=0.84$  grade gjermane,  $Mp=1191.69$  mg/l, uji eshte i tipit  $HCO_3-Na$ , ka permbajtja klori  $Cl=142$  mg/l.

### **3- Me ujembajtje te ulet:kemi perfshire depozitimet me perberje litologjike :**

- depozitime te Tortonianit-  $N_1^3t(d)$ -argjila, alevrovite, me ndershtresa ranore e qymyrore
- depozitime te Tortonianit-  $N_1^3t(b)$ - argjila, alevrovite, ranore
- depozitime te Tortonianit-  $N_1^3t(a+b)$ - )- argjila, alevrolite, ranore,
- depozitime te Miocenit te siper-  $N_1^3$  – ranore, argjila, konglomerate,
- depozitime te serravalianit  $N_1^2s$ - argjila, ranore dhe gelqerore me litotamie,
- depozitime te ladinianit  $N_1^2l$ - argjila, ranore dhe gelqerore me litotamie,

Ne shkembinjte kompakte me ujembajtje te vogel si depozitime e tortonianit  $N_1^3t(d)$ ,  $N_1^3t(b)$ , te serravalianit- $N_1^2s$   $N_1^2s(a)$ ,  $N_1^2s(b)$ ,  $N_1^2s(c)$ , te mesinianit-  $N_1^3$ , te ladinianit  $N_1^2l$ ,  $N_1^2l(a)$   $N_1^2l(b)$  me perberje litologjike argjila,alevrolite me ndershtresa ranore e qymyrore alevrolite,ranore karbonatike,konglomerate, gelqerore ranorik,gelqerore litotamnike etj. Keto formacione dalin ne siperfaqe nga Derveni, F.Kruja (Zall),Dritasi, Cerkez-Morina, Paskuqan, Farke e Madhe, Sauku, Stermas, Krraba, Mihajas(Lama), Kusi, Mamli(Nure), Daci, Kertusha, Likmetaj, Tarini, Mazha e Madhe, Preza, Marqinet, Koder Vora, Gjokaj, Allgjate, Maknor, Peze e Madhe, Ballashej, Pojane, Grece, Gjyslikane, Vrapit, etj.Daljet ne siperfaqe te ujrave te ketij kompleksi jane te pakta. Burimet karakterizohen me debite te vogla dhe te lekundhme 0.01-0.05 l/sek praktikisht te parendesishme dhe te pashfrytezueshme qe thahen gjate stines se veres. Puset fshatare jane te lidhura kryesisht me kapjen e ndonje ndershtrese ranori ne 6-15 m, grumbullojne pak uje dhe gjate stines se veres ato thahen. Niveli i ujit eshte i ndryshem ne varesi te lartesisive hipsometrike dhe lekundet 3.5-8m nga siperfaqja e tokes. Shpimet hidrogjeologjike te kryera nga subjektet private kane takuar ndershtresa ranore me trashesi 2-3-5 m. Shpimet e kryera mbi 100 m thellesi disponojne presion pjezometrik dhe dalin me vetederdhje ne siperfaqe me prurje  $Q=0,1$  l/sek Pompimet e kryera ne puset per studimin e kushteve hidrogjeologjike te formacionit Mezezi kane dhene pothuajse te njejtat rezultate. Me keto pompime eshte konstatuar se per ulje te nivelit 10.5 m debiti i ujit ne pus nuk i kalon 0.2-0,56 l/sek kurse debiti specifik 0.03-0.04 l/sek/m.

### **III. Shkembinj praktikisht pa uje:**

#### **1. shkembinj te shkrifet:** - kemi klasifikuar depozitimet kuaternare:

- -Holocenit-,Pleistocen-alQp<sub>3,c,d</sub>,pQp<sub>3-h</sub>- -kolvione, deluvione, proluvione, alevrite, rere, copa
- Holocen i vonshem-dQh<sub>2</sub>-depozitime te plazhit, rera, zhure- dQh<sub>2</sub>,
- Holocenit i siperperm laQh-sedimente lagunore-alevrite, rera, lende organike
- Ne kete kompleks kemi klasifikuar depozitimet e Holocenit-Pleistocen- kolvione, deluvione, proluvione-argjila, rera, copa, zhure, brekcie. Perhapen ne taracat e larta te lumejve e perrejve, shpate luginash, konuse, teraca mbizallishtore, gropa karstike etj. Keto formacione kane kane perhapje ne gjithe basenin njollash me siperfaqe relativisht te vogel dhe ne forme te nje brezi shtrihen nga Durresi ne drejtim te Porto-Romanos rreze brezit kodrinor ne perendim te Kenetes. Jane depozitim kuaternare te argjilizuara e kolmatuara, jujembajtese.

#### **2-Shkembinj kompakte:**

- depozitime te Akuitanianit-N<sub>1</sub><sup>1</sup> a(b) N<sub>1</sub><sup>1</sup> a(a)- flish i holle, argjila , ranore, konglomerate,
- depozitime te Burdigalianit-N<sub>1</sub><sup>1</sup>b(c+b),N<sub>1</sub><sup>1</sup>b(d), N<sub>1</sub><sup>1</sup>b(c), N<sub>1</sub><sup>1</sup>b(a), N<sub>1</sub><sup>1</sup>b- mergele, argjila gelqerore,ranore, konglomerate, gelqerore litotamnike,
- depozitime te Pliocenit- N<sub>2</sub><sup>1</sup>h (b+c)- argjila, ranore, konglomerate, alevrolite
- depozitime te Oligocenit -Pg<sub>3</sub><sup>3</sup>(b+c),Pg<sub>3</sub><sup>3</sup>(c),Pg<sub>3</sub><sup>3</sup>(b) Pg<sub>3</sub><sup>2</sup> Pg<sub>3</sub><sup>1</sup>(pk), Pg<sub>3</sub><sup>1</sup>(c) Pg<sub>3</sub><sup>1</sup>(b), Pg<sub>3</sub><sup>1</sup>(a) -flishi holle, argjila,alevrolite ndershtresa ranoresh, gelqerore e konglomerate
- depozitime te Paleocen-Eocen-Pg<sub>1-2</sub>-mergele te kuq dhe flish alevrolitor
- depozitimet e Jurasikut siperperm- J<sub>3</sub> -melanzhi “blloqe ne matriks”

Ky kompleks ka perhapje gjere ne forme te brezave ndermjet depozitimeve karbonatike me drejtim shtrirjeje JL-VP me gjeresi rreth 0.5-2.5km. Dalin ne siperfaqe dhe kane perhapje n ne Jug e Perendim te Malit me Gropa, ne Selita (Lestere), Zheja, Mafsheq, Shkrete, Kruje, Picrrage, Shenmeri, Bruze, Ranxa, Shupal, Murrize, Selita e Malit, Brrari, Priska e Vogel, Herraj, Mukja, Fraveshi, Pashkasheshi, Mollagjeshi, Prushi-Yzberish, Vaqari, Damjan-Fortuzaj, Picalle, Baldushk, Mustafa Kocaj, Lug Shalqize, Shenkoll, Lalzi, Hamallaj, Manza, Rada, Maminasi,Gjepalaj,Likesh, Romanat, Maskuria, Rrashbull, Shkallnur, Kryemedhej Keto formacione me litologji argjila, alevrolite, ranore, mergele, gelqerore ranorik, formacioni flishor jane praktikisht jo ujembajtes. Ne keto formacione takohen disa dalje natyrore te burimeve te vegjel ne Shenmeri, Picrrage me prurje Q=0.01-0.3 l/sek. Uji eshte me veti te mira fiziko kimike. Mineralizimi i pergjithshem eshte Mp=566.26-647.88 mg/l. UN te ketij kompleksi kane fortesi mesatare Fp=16.52-21.7 grade gjermane. Uji ka Ph=7.52-7.69. Uji eshte i tipit hidrokarbonat-kalcium-magnezi.Jane depozitime ujembeshtetese te perfaqesuara nga argjila, alevrolite, flishe, mergele jo ujembajtes. Kane shtrirje te madh ne lindje e jug te Tiranës dhe rajonin e Durresit. Formacini Helmesi i Pliocenit kane vendosje konkordante me moshat qe shtrihen poshte tyre. Dalin ne siperfaqe ne formen e nje brezi te ngushte dhe te gjate nga veriu ne jug. Perfaqesohen nga argjila, alevrolite, ranore dhe konglomerate. Ranoret kane trashesi deri 50m, jane kokerr mesem deri kokerrmedhenj me cimentim mesatar deri te bute, ndersa konglomeratet jane shume te cimentuar dhe facialisht kalojne ne ranore. Nga keto depozitime dalin burime te vegjel ne siperfaqe me regjim te ndryshueshem deri ne shterje te plote gjate periudhes ujepakte. ndryshme, mineralizimi i pergjithshem eshte 498.7-556 mg/l, Fp=12.12-14.92 grade gjermane, Ph=7.9-8.65Ne studimin e fenomeneve gjeologjike te kesaj zone jemi bazuar ne studimet ekzistuese dhe ne informacionet e reja qe kemi marre nga studimi aktual. Bazuar ne keto te dhena, po bejmepershkrimin e fenomeneve gjeologjike qe jane prezente ne formacionet gjeologjike qe takohen ne kete zone.Fenomenet me te dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike qe verehen ne kete zone jane:

### **1. Fenomeni i perajrimit**

### **2. Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve aluviale**

### **3. Fenomeni I Erozionit**

Keto fenomene po i shpjegojme nje nga nje me poshte:

**1. Fenomeni I perajrimit** eshte i dukshem tek formacionet rrenjesore qe perbehen nga argjilite dhe alevrolite. Keto shkembinj jane depozitime te reja dhe me çimentim te dobet argjilor dhe nen veprimin e agjenteve atmosferike transformohen nga shkembinj te bute ne dhera. Ky fenomen takohet me teper ne pjesen kodrinore te zones, aty ku shkembinjte jane te zhveshur nga mbulesa deluvialo eluviale. Ky fenomen eshte me i dukshen ne pjesen Veriore te zones ne kodrat e Paskuanit dhe ne zonen e “Kodres se Priftit”.

**2. Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve aluviale:** Keto depozitime perbehen nga shtresa suargjilash, surerash, zhavore, rera dhe argjilash me permbajtje lendesh organike. Ne kete pjese te teraces jane te vendosura depozitimet e lumit “Tirana” dhe te lumit “Lana”, te cilat nderthuren me depozitimet e perrejve te zones. Ne kohe te ndryshme, kjo fushe ka qene dhe nje liqen i mbyllur ne te cilin jane depozituar materiale me granulometri te imet dhe lende organike. Shtresat qe permbajne lende organike jane te pakonsoliduara ose pak te konsoliduara. Ne sheshin e studiuar nuk jane takuar shtresa me karakteristika te dobeta fiziko-mekanike, por neqoftese gjate hapjes se themeleve takohet ndonje shtrese e tille, menjehere duhet te lajmerohet Ing.gjeolog dhe projektuesi per te bere ndryshimet e duhura. Shtresat e rera dhe te zhavoreve konsolidohen me shpejt ne kohe se sa shtresat me perberje argjilore. Ne zonen e studiuar ka nje drenim te mire te ujrave nentokesore por ne periudhat me rreshje masive niveli i ujit nentokesor eshte afer siperfaqes se tokes. Duhet te tregohet vemendje per mbrotjen e skarpatave te germimeve te ndryshme sepse ato rrezikojne dhe objektet ngjitur me kete objekt te ri. Skarpatat me lartesi me shume se 3.00m duhet te mbrohen me masa inxhinierike.

**3. Fenomeni i Erozionit:** Ky fenomen eshte shume i dukshen ne dy brigjet e lumit te “Tiranes” dhe lumit te “Lanes”. Ne rastet kur ka rreshje masive, te gjitha objektet qe jane prane brigjeve te ketij lumi jane te kercenuara, me perjashtim te rasteve kur jane masat kunder gerryrjeve. Rekomandojme qe me sitemimin e lumit te tregohet vemendje per teneuralizuar kete fenomen negativ gjeologjik. Nje vemendje duhet te tregohet dhe ne rastin e themeleve te urave. Fenomeni i gerryerjes eshte dhe ne shpatet e kodrave. Ne rastin kur ka rreshje masive, ujrat siperfaqesore rjedhin ne drejtim te renies se relievit dhe gerryejne depozitimet deluviale qe jane prezente ne kete zone. Per te mbrojtur trupin e rruges se re ne rekomadojme sitemimin e ujrave siperfaqesore me kanalet qe jane anash rruges se re dhe ne koken e germimeve. Ujrat duhet te drejtohen ne tombinot ose urat qe jane me afer.


### **MBI FENOMENET GJEODINAMIKE NE SHESH E PERRETH**

Nga rikonicioni i kryer ne shesh e perreth tij per evidentimin e fenomeneve gjeodinamike te cilat rrezikojne objektin egzistues, veme re se aktualisht ne shesh nuk kemi probleme te tilla. Sheshi i ndertimit nga pikpamja gjeomorfologjike perfaqeson kodrat ne pjesen lindore te tiranes ne zonen e Freskut Studimi yne ka rendesi per rikonstruksionin e rruges te brendeshme dhe sistemi i ndertimit te shkarkimit te ujrave te zeza dhe te bardha ne keto zona ku do te jete influencia litologjike aluvionale .

### **Problem i rendesishem do te jete situata qe do te krijohet pas se kanalit per vendosjen e tubacioneve dhe deri ne momentin e ndertimit te kanalizimeve .**

Per kete duhet te merren masa qe te mos krijohen rreshqitje te cilat te arrijne kendin e ferkimit te brendeshem te shtresave duhet te mbulohen konturet e kanalit me plasmas ne qoftese do te rrin gjate hapur nga shirat qe lagin faqet e saj dhe do te ndodh fenomeni i rreshqitjes nga lageshtia mbi faqet e kanalit

sidomos ato te ujrave te zeza. Germimi i rruges nuk sjell problem me rreshqitje se thellsia e germimit eshte e vogel.



Fragment nga harta e rrezikut gjologjik

## **KONDIAT GJEOLIGO – INXHINIERIKE TE SHESHIT**

Bazuar ne dokumentimin e kampioneve te marre ne siperfaqen e Rilevuar, kryerja e analizave laboratorike te tyre si dhe te materialeve arkivale e te pervojes tone ne studime te ketij lloji, kemi vecuar keto shtresa me perberje litologjike dhe parametra fiziko-mekanike si me poshte:

### Shtresa Nr.1

Perbehet nga toke vegetale,.Kjo shtrese ka trashesi qe arrin 0.8 ml Ne pjesen fushore te sheshit mbizoteron toka vegetale. Kjo shtrese nuk do te perdoret per hedhjen e themeleve.

### Shtresa Nr.2

Suargjil e lehte e mesme , me ngjyre gri ne kafe, me copezore (jo homogjen )proluviale , lageshti mesatare, pak deri mesatarisht e ngjeshur. Trashesia shkon deri 1.5 m

Ka keto parametra fiziko-mekanike:

#### *Granulometria*

- fraksioni argjilor 35.4%
- fraksioni pluhuror 17.3%
- fraksioni ranor 47.3 %

#### *Pasticiteti*

- kufiri i siperme i plasticitetit  $W_s = 36.2\%$
- kufiri i poshtem i plasticitetit  $W_p = 28.2\%$
- nr.plasticitetit  $F = 9$
- *Lageshtia natyrale*  $W_0 = 32.85\%$
- *Konsistenca*  $0.50$
- *Pesha volumore natyrale*  $\Delta = 1.86T/m^3$



• <i>Pesha specifike</i>	$2.68\text{gr/cm}^3$
• <i>Koeficienti i porozitetit</i>	$0.91$
• <i>Moduli i kompresionit</i>	$E_{1-3} = 95\text{kg/cm}^2$
• <i>Kendi i ferkimit te brendshem</i>	$\varphi = 18^\circ$
• <i>Kohezioni</i>	$c = 0.25\text{kg/cm}^2$
• <i>Ngarkesa e lejuar</i>	$\sigma = 1.7\text{kg/cm}^2$

### Shtresa nr 3

Suargjile e lehte , ngjyre gri pak bezhe , me lageshti pak e ngjeshur Mikroporoze. Trashesia shkon deri 1.4m. Vetite fiziko-mekanike te shtreses jane si me poshte :

#### Granulometria

• fraksioni argjilor	13.5%
• fraksioni pluhuror	42.5%
• fraksioni ranor	44.0 %

#### Plasticiteti

• kufiri i siperm i plasticitetit	$W_s = 38.1\%$
• kufiri i poshtem i plasticitetit	$W_p = 26.1\%$
• nr.plasticitetit	$F = 12$
• <i>Lageshtia natyrale</i>	$W_0 = 29.5\%$
• <i>Kosistenca</i>	$0.3$
• <i>Pesha volumore natyrale</i>	$\Delta = 1.90\text{T/m}^3$
• <i>Pesha specifike</i>	$2.7\text{gr/cm}^3$
• <i>Pesha e vellimit te skeletit</i>	$1.45\text{gr/cm}^3$
• <i>Poroziteti</i>	$46\%$
• <i>Koeficienti i porozitetit</i>	$0.93$
• <i>Moduli i kompresionit</i>	$E_{1-3} = 160\text{kg/cm}^2$
• <i>Kendi i ferkimit te brendshem</i>	$\varphi = 18^\circ$
• <i>Kohezioni</i>	$c = 0.32\text{kg/cm}^2$
• <i>Ngarkesa e lejuar</i>	$\sigma = 2.2\text{kg/cm}^2$

### Shtresa nr 4

Zhavore proluvial argjilore me ngjyre gri ne kafe jane te ngopur me uje, jo homogjen dhe fraksion trashe , mesatarisht te ngjeshur. Trashesia 3.0m Vetite fiziko-mekanike te shtreses jane si me poshte :

#### Granulometria

• fraksioni argjilor dhe pluhrore	22.7%
• fraksioni rerore (0.06-2mm )	18.7%

- fraksioni zhavorore (>2.0mm ) 58.6%
- Pesha volumore natyrale  $\Delta = 2.0 \text{ T/m}^3$
- Moduli i kompresionit  $E_{1-3} = 300 \text{ kg/cm}^2$
- Kendi i ferkimit te brendshem  $\phi = 35^\circ$
- Kohezioni  $c = 0.1 \text{ kg/cm}^2$
- Ngarkesa e lejuar  $\sigma = 2.8 \text{ kg/cm}^2$

### SHTRESA Nr.5

Perfaqesohet nga; Argjilite, alevrolite dhe ranore, me ngjyre gri ne bezhe, jane me çimentim te dobet dhe me pak çarje, jane te forta, te ngjeshura. Ne disa raste takohen shtresa ranori me çimentim shume te mire dhe shune te veshtira per t'u shpuar me sonde. Takohet ne shtresat:shiko prerjet gjeologo-litologjike. Jane te kontrolluar nga grupi i studimit dhe nga autore te tjere, trashesia e kesaj shtrese eshte 100-200m e thelle.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese te merren:

- Lageshtira natyrrale  $W_n = 8.60\%$
- Pesha volumore ne gjendje natyrale  $\Delta = 2.25 \text{ T/m}^3$
- Kendi i ferkimit te brendshem  $\phi = 32^\circ$
- Kohezioni  $C = 0.94 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i deformacionit  $1230 \text{ kg/cm}^2$
- Rezistenca ne shtypje nje boshtore  $R_{sh} = 30-35 \text{ kg/cm}^2$
- Ngarkesa e lejuar ne shtypje  $\sigma = 4.0-4.50 \text{ kg/cm}^2$
- Reguesi CBR  $\text{CBR} = 7-8\%$

### **KOLLNA PERMBLEDHESE LITOLOGJIKE E SHESHIT TE STUDIMIT**

Mosha	Kolona litologjike	Pershkrimi gjeologo - inxhinierik
Kuaternar	0-0.6m	Toke vegjetale e perpunuar nga dora e njeriut
	0.6-1.5m	Suargjile e mesme me ngjyre bezhe ne gri me pak lageshti e ngjeshur me konsistence te fort
	1.5-3.2m	Suargjile ngjyre kafe e hapur ne gri . eshte me lageshti mesatarisht e ngjeshur , konsistence plastike
	3.2-8.5m	Zhavore proluvial argjilore me ngjyre gri ne kafe jane te ngopur me uje, jo homogjen dhe fraksion trashes , mesatarisht te ngjeshur

### **PERFUNDIME DHE REKOMANDIM**

- Vendi i ndertimit ndodhet ne tajonin nr.12 me sipefaqe  $28000 \text{ m}^2$
- Rezistenca ne shtypje luhetet nga  $1.7- 2.8 \text{ kg/cm}^2$
- Para hedhjes se materjaleve per ndertimin e rrugeve te thirret gjeologu per te pare sheshin ne pamje faktike dhe te firmos process-verbalin e hapjes se shtresave te rruges .

- Per cdo problem qe mund te dale gjate zbatimit dhe qe ka lidhje me studimin gjeologo – inxhinierik te merret kontakt me autorin e studimit.
- Nga ana zizmike te llogaritet me 8 balle

**Telefon mobil. 069 5160114**

***AUTORI I STUDIMIT***

**Ing.Gjeolog Yzeir Miraka**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit

**L I C E N C Ë**  
**GJ.0244/2**

<b>MBIEMRI</b>	<b>MIRAKA</b>
<b>EMRI</b>	<b>YZEIR</b>
<b>ATËSIA</b>	<b>REFAT</b>
<b>DATËLINDJA</b>	<b>24.12.1957, Gramsh</b>
<b>VENDBANIMI</b>	<b>ELBASAN</b>
<b>DIPLOMUAR, MË</b>	<b>1982</b>
<b>TITULLI</b>	<b>Ing. Gjeolog</b>
<b>Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :</b>	<b>21.06.2017</b>



**NË PROJEKTIM**

Kat.	9	a	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
		b	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.
		c	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/Ç, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.
		d	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
		e	Studime e projektme hidrogjeologjike.

**KRYETARI I KOMISIONIT**

**GERTA LUBONJA**

